

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 6691 Rep.  
Nr. 2035 Kol.



### KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë 22/11/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), përpara meje notere Manushaqe H. Jaupi me seli pranë Rr. "George W. Bush", pallati 13 katësh, kati i 1-rë, Anëtare e Dhomës së Notereve Tiranë u paraqitën personalisht palët:

**Shkëlqim FUSHA** i biri i Demiri-it, i datëlindjes 05.12.1964, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i ID nr. G41205103E, Ortak i shoqërisë "Alentre" Sh.p.k,

*në vijim Shitësi;*

dhe

**Romina SHELQIZI**, e bija e Begtash-it, i datëlindjes 24.05.1989, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e ID nr. I95524078W, në vijim *Blerësi;*

të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate shitje kuotash, në vijim *Kontrata*, me përmbajtjen si më poshtë:

#### Kushte paraprake

- Shitësi Shkëlqim FUSHA është ortakë i Shoqërisë "Alentre" Sh.p.k, e cila është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar si person juridik në datën 03.07.2012.
- Sipas dokumentacionit të depozituar pranë QKB, kapitali i shoqërisë është 1000,00 (njëmijë) lekë dhe përbëhet nga 2 kuota, me vlerë nominale 1,346,000 lekë, nga të cilat Shitësi zotëron 1 kuota me përqindje të pjesëmarrjes në kapital 51 %.
- Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 3 datë 21.11.2019 është vendosur që Ortaku, Shkëlqim FUSHA, t'i shes blerëses Romina SHELQIZI, 51% të kapitalit themeltar dhe të gjithë vlerën e kuotave që shitësi zotëron në Shoqërinë "Alentre" Sh.p.k.
- Shoqëria ka si objekt veprimtarie Ndërtim, Rikonstruksion etj. Shitësi deklaron se në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria funksionon normalisht dhe ajo nuk është në gjendje falimenti apo likuidimi;

#### *Neni 1* *Objekti*

*Shitësi*, nëpërmjet *Kontratës* transferon (shet) tek *Blerësi* 1 kuota të barabartë me 51% të kapitalit të zotëruar prej tyre në Shoqërinë "Alentre" Sh.p.k, me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.9901 datë

14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i përditësuar), Statutin e Shoqërisë dhe Vendimin nr.3 datë 14.11.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

#### *Neni 2*

#### *Çmimi i shitjes*

Çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit të zotëruara nga Shitësit, që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate në favor të Blerësit, është 1,686,460 (një milion e gjateqind e tetedhejete e gjashte mije e katerqind e gjatedhjetë ) lekë, të cilat do të transferohen nga Blerësi Znj. Romina SHELQIZI tek Shitësi brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

#### *Neni 3*

#### *Kalimi i pronësisë*

Palët bien dakord që pronësia mbi kuotat do të kalojë nga shitësit tek blerësi vetëm pasi të jetë depozituar shuma prej 1,686,460 (një milion e gjateqind e tetedhejete e gjashte mije e katerqind e gjatedhjetë ) lekë në numrin e llogarisë IBAN AL8620511564185631CLIDCLALLA.

Një kopje e kësaj kontrate shitjeje do të depozitohet pranë QKB-se, në mënyrë që të bëhet pasqyrimi i kalimit të pronësisë.

#### *Neni 4*

#### *Të drejtat dhe detyrimet e shitësit*

- 4.1. **Shitësit** marrin përsipër, garantojnë dhe sigurojnë **Blerësin** se deri në momentin e lidhjes dhe nënshkrimit të Kontratës kuotat :
- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
  - Shitësi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjerë që kanë pretendime në lidhje me këto kuota;
  - Nuk ka asnjë kontratë të lidhur më parë e cila të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi kuotat.
- 4.2. **Shitësi** është i detyruar të paguajë detyrimet në shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të Kontratës. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga ortakët në raport me detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave.

#### *Neni 5*

#### *Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit*

- 5.1. **Blerësi** që nga momenti i nënshkrimit të **Kontratës**, paguan çdo taksë mbi kapitalin që zotëron në shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve, shtetit, etj.
- 5.2. **Blerësi** ka të drejtë që të sillet si pronar i ligjshëm i kuotës nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.
- 5.3. **Kontrata** është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë, etj. të palëve.

#### *Neni 6*

#### *Zgjidhja e Kontratës*

- 6.1. Palët nuk mund ta zgjidhin Kontratën në mënyrë të njëanshme përveç kur kemi mospërbushje të detyrimeve kontraktuale.



6.2. Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në Kontratë në mënyrë të njëanshme. Për çdo ndryshim të domosdoshëm të Kontratës, diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëra tjetrën me shkrim në adresat përkatëse dhe vetëm pasi kanë rënë dakord mund të bëjnë ndryshime të Kontratës.

**Neni 7**

**Interpretimi i Kontratës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

7.1. Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

7.2. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të Kontratës, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 8**

**Dispozita kalimtare dhe të fundit**

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim në adresat e përshkruara në Kontratë duke pasur parasysh që të dërgohet sa më shpejt.

Unë, noteri publik, pasi i lexova përmbajtjen e kësaj prokure palëve dhe e gjeta në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

Kontrata përpilohet në 3 (tre ) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore.

**SHITËSI**

Ortak i shoqërisë "Alentre" Sh.p.k

Z.Shkëlqim FUSHA



**BLERËSI**

Znj.Romina SHELQIZI

Romina Shelqizi

**NOTER**

Manushaqe Jaupi

